



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendos:** Gjykatësi i Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrësi Parashtrues:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 4 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Njoftim për caktimin e kushtëzuar të mbrojtësit për Hysni Gucatin**

**me shtojcë konfidenciale**

---

**Zyrës e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit për Hysni Gucatin**

Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit kujdestar për Nasim**

**Haradinajn**

Bastian Martens

1. Në pajtim me rregullën 26(1) të Rregullores<sup>1</sup>, Administratorja informon Gjykatësin e Vetëm për caktimin e kushtëzuar të z. Xhonatan Elistan Ris si mbrojtës të z. Hysni Gucati ('z. Gucati').
2. Në pajtim me pjesën 18(6) të Direktivës për Mbrojtësit<sup>2</sup>, Administratorja gjithashtu informon Gjykatësin e Vetëm për tërheqjen e z. Valon Hasani si bashkëmbrojtës dhe miratimin e z. Hju Bouden (Huw Bowden) si bashkëmbrojtës i z. Gucati.

## I. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në përputhje me pjesën 12(1) (a)-(b) të Direktivës për Mbrojtësit, Administratori *emëron* mbrojtësin e zgjedhur për të dyshuarin ose të akuzuarin që ka mjete financiare të mjaftueshme për të marrë në shërbim mbrojtës dhe *cakton* mbrojtësin për një të dyshuar ose të akuzuar që i mungojnë plotësisht ose pjesërisht mjetet financiare për të paguar mbrojtësin nëse provohet se është plotësisht ose pjesërisht i varfër në pajtim me Rregulloren e Ndihmës Juridike ('RRNJ').<sup>3</sup>
4. Deri në caktimin e mbrojtësit, Administratori mund të caktojë me kusht mbrojtësin për një të dyshuar ose të akuzuar në pajtim me RRNJ-në.<sup>4</sup>
5. Mbrojtësi i emëruar apo i caktuar mund t'i zgjedhë anëtarët e ekipit të vet, përfshirë edhe bashkëmbrojtësin, në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.

## II. EMËRIMI

6. Më 28 shtator 2020, z. Gucati kërkoi emërimin e z. Ris si mbrojtës dhe ka nënshkruar autorizimin për përfaqësim prej mbrojtësit. Administratorja emëroi z. Ris

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, e ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020 ('Rregullorja'); *Shih gjithashtu* Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

<sup>2</sup> Direktiva për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017.

<sup>3</sup> Rregullorja e Ndihmës Juridike, KSC-BD-25, 3 shtator 2020.

<sup>4</sup> *Shih* Direktivën për Mbrojtësit, pjesa 14(3); Rregullorja e Ndihmës Juridike, rregulla 11(1).

si mbrojtës në pajtim me pjesët 12 dhe 13 të Direktivës për mbrojtësit.<sup>5</sup>

### III. CAKTIMI

7. Më 16 tetor 2020, z. Gucati i paraqiti Administratores, përmes shefit të Zyrës së Mbrojtjes, formularin e kërkesë për ndihmë juridike dhe kërkesën përkatëse për caktimin e z. Ris si mbrojtës.<sup>6</sup>

8. Më 30 tetor 2020, në pritje të përfundimit të vlerësimit të varfërisë, Administratorja caktoi me kusht z. Ris si mbrojtës së z. Gucati për fazën e procedurës para Aktakuzës.<sup>7</sup>

9. Më 3 nëntor 2020, z. Ris u pajtua me përcaktimin e përkohshëm të honorarit për ndihmë juridike.

10. Pas përfundimit të formaliteteve të kontratës, Administratorja ia miraton z. Ris kontratën në pajtim me rregullën 11(3) të RRNJ-së, që ka efekt prapaveprues nga data që z. Gucati ka paraqitur formularin e kërkesës për ndihmë juridike.<sup>8</sup>

11. Në pajtim me rregullën 11 të RRNJ-së, z. Gucati është informuar se do t'i kthejë shpenzimet e plota ose të pjesshme të përfaqësimit juridik, nëse më vonë konstatohet se nuk është i varfër ose pjesërisht i varfër, nëse nuk bashkëpunon në vlerësimin e varfërisë së plotë ose të pjesshme të tij; ose nëse ka dhënë informacion të rremë, ose ka qëllimisht nuk ka përmendur informacion relevant për vlerësimin e varfërisë së plotë ose të pjesshme të tij.

### IV. BASHKËMBROJTËSI

12. Më 28 shtator 2020, me kërkesë të mbrojtësit, Administratorja miratoi z. Valon Hasani si bashkëmbrojtës të z. Gucati në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për

---

<sup>5</sup> *Shih* KSC-BC-2020-07/F00024, Njoftim për emërimin e mbrojtësit, 28 shtator 2020, publik; *Shih gjithashtu* Direktivën për Mbrojtësit, Pjesët 12, 13.

<sup>6</sup> *Shih* Shtojca 1.

<sup>7</sup> *Shih* Shtojca 1.

<sup>8</sup> *Shih* Shtojca 1.

Mbrojtësit.<sup>9</sup>

13. Më 17 tetor 2020, në përputhje me pjesën 18(6) të Direktivës për Mbrojtësit, z. Ris e informoi Zyrën e Mbrojtjes se z. Hasani kishte ndërmend të tërhiqej si bashkëmbrojtës për z. Gucati. Z. Ris gjithashtu e informoi Zyrën e Mbrojtjes më 20 tetor 2020 se ndërprerja e kontratës me z. Hasani si bashkëmbrojtës do të bëhej pa pasoja të dëmshme juridike për interesat e z. Gucati dhe për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.

14. Më 20 tetor 2020, z. Ris gjithashtu kërkoi nga Administratorja që të miratojë si bashkëmbrojtës z. Hju Bouden, i cili aktualisht është anëtar i ekipit të Mbrojtjes. Z. Bouden është pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar në pajtim me pjesën 18(1) të Direktivës për Mbrojtësit.<sup>10</sup>

15. Më 30 tetor 2020, Administratorja e informoi z. Ris për miratimin e z. Bouden si bashkëmbrojtës për z. Gucati dhe miratimin e tërheqjes së z. Hasani si bashkëmbrojtës.

## V. KLASIFIKIMI

16. Ky parashtrim protokollohet si publik, ndërsa shtojca 1 protokollohet si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, meqenëse ajo përmban të dhëna personale për z. Gucati, konkretisht, numrin e pasaportës së tij, si dhe të dhëna personale për mbrojtësin, konkretisht, të dhënat e kontaktit dhe numrin e pasaportës.

**Numri i fjalëve: 771**

/nënshkrimi: Fidelma Donlon/

**Dr. Fidelma Donlon**  
**Administratore**

---

<sup>9</sup> *Shih* KSC-BC-2020-07/F00024, para. 8.

<sup>10</sup> Vendimi për pranimin në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, KSC/REG/DEF/0074, 25 prill 2019.

E hënë, 2 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë